



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 mars 2013  
Nr. ref.:RK398/13

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KI130/12**

Parashtrues

**Xhymshit Xhymshiti**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së njoftimit të Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim  
Prokurorial, ZZVP/12/123, të 23 nëntorit 2012**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është Xhymshit Xhymshiti, avokat nga Gjilani.

## **Vendimet e kontestuara**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston njoftimin ZZVP/12/213 e Panelit Vlerësues të Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim Prokurorial, e 23 nëntorit 2012, dorëzuar parashtruesit më 24 nëntor 2012, dhe vendimin e Panelit për Rikonsiderim të Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK/82, e 30 nëntorit 2012.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekti i çështjes është shkelja e pretenduar e të drejtës në punë nga Paneli Vlerësues i Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim Prokurorial, si dhe interpretimi kushtetues i përvojës 25-vjeçare të parashtruesit të kërkesës në gjyqësinë kosovare.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenin 20 dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe në rregullin 36.1 (a) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 18 dhjetor 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 janar 2013, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI130/12, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me vendimin Nr. KSH. KI130/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Enver Hasani.
7. Më 1 shkurt 2013, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.
8. Më 28 shkurt 2013, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin, Zyrën për Vlerësim dhe Verifikim Prokurorial dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës për regjistrimin e kërkesës në regjistrin përkatës të Gjykatës.
9. Më 13 mars 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Më 22 maj 2012, Këshilli Prokurorial i Kosovës shpalli konkurs për vende të lira pune për prokurorë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe prokuroritë komunale të Gjilanit dhe të Ferizajt.
11. Parashtruesi aplikoi për pozitën e prokurorit në prokuroritë komunale të Gjilanit dhe të Ferizajt dhe, më 24 nëntor 2012, u njoftua nga Paneli Vlerësues i Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim Prokurorial se nuk ishte rekomanduar për pozitën që kishte aplikuar dhe se kandidatët e tjerë ishin treguar më të suksesshëm.
12. Parashtruesi i paraqiti kërkesë Panelit për Rikonsiderim të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe, më 4 dhjetor 2012, paneli në fjalë refuzoi kërkesën e parashtruesit për rikonsiderim, duke arsyetuar se është vërtetuar se parashtruesi ka pasur më pak pikë se kandidatët e tjerë, të rekomanduar nga Paneli Vlerësues.

## **Pretendimet e parashtruesit**

13. Parashtruesi pretendon se Paneli Vlerësues dhe Paneli për Rikonsiderim, të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me njoftimet, përkatësisht me vendimet e tyre, duke mos e rekomanduar parashtruesin për pozitën e prokurorit në Gjilan dhe në Ferizaj, kanë shkelur të drejtën e tij për punë si dhe nenin 61 [Përfaqësimi në Punësim në Institucionet Publike] të Kushtetutës.
14. Parashtruesi pretendon se kërkesa e tij ka bazë kushtetuese, sepse, gjatë aplikimit për pozitën e prokurorit, ka ofruar fakte dhe dokumente të vërtetuara përkitazi me përvojën e tij 25-vjeçare në gjyqësinë kosovare.
15. Parashtruesi kërkon që Gjykata të bëjë interpretimin e përvojës së tij 25-vjeçare në gjyqësinë kosovare, si dhe të konstatojë shkeljen e të drejtave të tij nga Paneli Vlerësues dhe nga Paneli për Rikonsiderim, kur kanë vlerësuar se parashtruesi nuk ka arritur numrin e nevojshëm të pikëve për t'u rekomanduar për pozitën e prokurorit komunal në prokurorinë komunale në Gjilan apo në Ferizaj.
16. Parashtruesi, në kërkesën e tij në këtë Gjykatë, ka ofruar dëshmi për përvojën e tij si jurist në gjyqësinë kosovare, duke përfshirë edhe përvojën e tij si prokuror dhe gjyqtar.
17. Për më tepër, parashtruesi pretendon që *“është shumë e vërtetë se kandidatët e propozuar nuk kanë asnjë vit pune eksperiencë në prokurori”*.

## **Vlerësimi i pranueshmërisë**

18. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës.
19. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës:

*“Individët janë autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
20. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 10.1 dhe nenit 11 të Ligjit për Konfliktet Administrative, Nr. 03/L-202, ku përcaktohet:

*“Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor”.*

*“Konflikti administrativ, sipas padisë<sup>1</sup>, zgjidhet nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës”.*
21. Nga dokumentet e dorëzuara shihet qartë se parashtruesi nuk ka iniciuar konflikt administrativ, bazuar në legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe, si rrjedhojë, nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.
22. Arsyetimi mbi rregullin e shterimit është që t'u ofrohet autoriteteve kompetente, duke përfshirë gjykatat, mundësia për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e

---

<sup>1</sup> Ligji Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative e përdorë termin “akt-padi”.

supozuara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (*Shih, Aktvendimi për papranueshmëri: AAB-RIINVEST L.L.C. Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI41/09, i 21 janarit 2010; dhe shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25 803/94, vendim i 28 korrikut 1999*).

23. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ngjashme, më 18 maj 2011, në Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin Nr. KI114/10, Parashtruese Vahide Badivuku, Vlerësim i kushtetutshmërisë të Njoftimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për riemërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, Nr. 01/118-713, i 27 tetorit 2010.
24. Rrjedhimisht, kërkesa është e papranueshme për shkak të mosshterjes së të gjitha mjeteve juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës; në mbështetje të nenit 47 të Ligjit; si dhe në pajtim me rregullin 36.1 (a) të Rregullores së punës, më 13 mars 2013, njëzëri

### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

  
Dr. sc. Kadri Kryeziu



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

  
Prof. dr. Enver Hasani